

VENDIM
Nr. 113, datë 15.2.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 2.397 HA NË NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE
“PETRAN ZAVALAN”, NË PËRMET, PËR NDËRTIMIN E HEC-VE “LENGARICA 1” E
“LENGARICA 2”, NGA SHOQËRIA “LENGARICA & ENERGY”, SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 2.397 ha, në ngastrat 122b, 210a, 215, 247, 248a dhe 258c, të ekonomisë pyjore “Petran Zavalan”, në Përmet, objekt i ndërtimit të hec-eve “Lengarica 1” dhe “Lengarica 2”, nga shoqëria “Lengarica & Energy”, sh.p.k., të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për ngastrat pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt mineral, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe të volumit të lëndës drusore, në sipërfaqen objekt mineral, paguhen nga shoqëria “Lengarica & Energy”, sh.p.k., në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Lengarica & Energy”, sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen pyjore sipas kushteve të lejes mjedisore dhe, brenda vitit të parë, të pyllëzojë me fondet e veta një sipërfaqe prej 1.8 ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshjen me Ministrinë e Mjedisit.

4. Ministria e Mjedisit dhe shoqëria “Lengarica & Energy”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullorore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i ndërtimit të hec-ve “Lengarica 1” dhe “Lengarica 2”.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Lengarica & Energy”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

*LISTA E NGASTRAVE DHE NËN NGASTRAVE QË HIQEN NGA FONDI
PYJOR DHE KULLOSOR PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT LENGARICA
në qarkun GJIROKASTËR*

(Per rruge,vepra e marrjes,bazeni i presionit dhe godina)

QARKU GJIROKASTËR

Lidhja 1

<i>ID Prones</i>	<i>Ekon.Pyjore/Kullos ore</i>	<i>Ngastra</i>	<i>Administrimi</i>	<i>Sip. qe preket (ha)</i>	<i>Perdorimi territorit</i>
GJ 45 1	Petran-Zavalan	122b	Ministria Mjedisit	0.0958	inproduktive
GJ 45 1	Petran-Zavalan	210a	Ministria Mjedisit	0.5696	shkurre
GJ 45 1	Petran-Zavalan	215	Ministria Mjedisit	0.2763	shkurre
GJ 45 2	Petran-Zavalan	247	Komuna Petran	0.242	shkurre
GJ 45 2	Petran-Zavalan	248 a	Komuna Petran	0.7077	shkurre
GJ 45 2	Petran-Zavalan	258c	Komuna Petran	0.506	inproduktive
	GJTHSEJ			2.3974	

